



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

## E K S T R A K T

**i mbledhjes së dytë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 12.2.2025, me fillim në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Arton Brahim, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh.

**Munguan:** Trieria Kasumi – Berisha, Adnan Ajeti dhe Faton Marolli.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Fisnik Dida - zyrtar nga OSBE-ja, Arianita Beqa - Rraci - zyrtare nga UNMIK-u, Klaudia Mula - zyrtare nga ZKKK dhe Gjulia Datovo - zyrtare nga OSBE-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Mirsada Behluli, kryesuese e komitetit me këtë:

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për KFOR-in, UNHCR-in, PK-në dhe ZKKK-në;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, a) analizë e projekteve të komuniteteve joshumicë;
4. Formimi i Komisionit për takim me zyrtarët e Departamentit për komunitete në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK):
  - a) MKK subvencionim,
  - b) Propozim për ndihma tjera për komunitetet joshumicë,
5. Ndihmë përmes Komunës së Prishtinës për subvencionim për bizneset private, donacione, OJQ, etj.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të ZKKK-së për vitin 2024 dhe për muajin janar 2025;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Komitetit Komunal Veprues për vitin 2024;
8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
9. Të ndryshme.

**Mirsada Behluli, kryesuese:** konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

#### **Pika e parë**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Oktai Kurtesh:** - bëri vërejtje në ekstrakt duke thënë se, në diskutimin tim ka qenë fjala për një rast (një grua), të cilën e kanë larguar prej shtëpisë së saj dhe e kanë vendosur me vendbanim tek universiteti e cila jeton në kushte të rënda, megjithëse kanë thënë se do t'ia paguajnë qiranë. Pra ne kemi pasur kërkesë që t'ia paguajnë qiranë pasi që e kanë larguar prej shtëpisë së vet.

**Me vërejtjen e dhënë, kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

#### **Pika e dytë**

#### **Ftesë për KFOR-in, UNHCR-in, PK-në dhe ZKKK-në**

**Mirsada Behluli, kryesuese:** - tha se, sa i përket ftesës së KFOR-it, Policisë së Kosovës, UNHCR-it UNMIK - ut, ne jemi të detyruar që dy herë në vit të bëjmë ftesën që të na raportojnë për punën e tyre. Tani me ardhjen e shefit të ri të KFOR- it, ka shpreh dëshirën që në takimin e ardhshëm të na raportojë diçka më shumë lidhur me situatën.

**Klaudia Mula:** - tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, neve nuk na është paraqitur asnjë kërkesë apo ankesë në lidhje me sigurimin e komuniteteve joshumicë, kështu që ne jemi të hapur për bashkëpunim për secilin përfaqësues të komuniteteve.

#### **Pika e tretë**

#### **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, a) analizë e projekteve të komuniteteve joshumicë.**

**Mirsada Behluli, kryesuese:** - tha se jam informuar se drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale është i zënë, kështu që mbetet që në takimin e radhës të na informojë për punën e kësaj drejtorie.

#### **Pika e katërt**

#### **Formimi i Komisionit për takim me zyrtarët e Departamentit për komunitete në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK):**

- c) MKK subvencionim,
- d) Propozim për ndihma tjera për komunitetet joshumicë.

**Mirsada Behluli, kryesuese:** - tha se ne mund të formojmë komisionin dhe kërkojmë nga znj. Klaudia të na ndihmojë, që paraprakisht të caktohet një takim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, lidhur me këtë çështje. Kisha propozuar që të gjitha problemet e komunitetit joshumicë, sa i përket banimit, problemeve tjera të ndryshme dhe kthimit, të bëjmë një kërkesë me shkrim dhe ta dërgojmë në ministri.

**Klaudia Mula:** - tha se, ne si zyrë disa herë kemi kontaktuar me Zyrën për komunitete në ministri dhe kemi arritur të organizojmë një takim, mirëpo anëtarët e Komitetit për Komunitete nuk kanë pas mundësi me marrë pjesë, kështu që është anuluar takimi. Përkohësisht nuk kemi ndonjë informatë se kush është drejtor aty, për shkak se është shkarkuar drejtori, meqë sigurisht Zyra për komunitete ndërmjetëson për angazhimin në caktimin e këtij takimi.

**Mirsada Behluli, kryesuese:** - kërkoi nga Zyra për komunitete që në momentin kur të krijohen kushtet optimale, të bëhet një termin me ministrinë.

#### **Pika e pestë**

**Ndihmë përmes Komunës së Prishtinës për subvencionim për bizneset private, donacione, OJQ, etj.**

**Mirsada Behluli, kryesuese:** - tha se shkurtimisht do të flas për subvencionet të cilat realizohen nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, të cilat i ka mundësuar Komuna e Prishtinës përmes drejtorive përkatëse që ka të bëjë me kulturë, arsim, sport dhe të tjera, pasi që japin ndihmë me pako higjienike dhe ushqimore, kampingun për nxënësit e shkollave në dy faza, festimi i festave kombëtare të komuniteteve joshumicë, regjistrimi 1- mujor pa pagesë për komunitetin ashkali dhe egjiptian, festimin e 1 Qershorit. Po ashtu subvencionimi për komunitetet joshumicë, të cilat i ka organizuar Drejtoria e Kulturës për organizata joqeveritare në realizimin e shumë projekteve të ndryshme.

**Klaudia Mula:** - tha se Komuna e Prishtinës i ka mbështet të gjitha këto projekte për komunitete siç i ceku kryesuesja e këtij komiteti, të gjitha këto me kërkesën tonë, të Zyrës për Komunitete duke u bazuar në gjendjen e rëndë ekonomike të anëtarëve të komuniteteve joshumicë. Zakonisht OJQ-të i mbështet Drejtoria e Kulturës me aktivitete kulturore, gjithashtu Drejtoria e Bujqësisë edhe drejtoritë tjera. Po ashtu tha se ju njoftoj se Organizata Ndërkombëtare për Migrim IOM shpreh dëshirën për t'i subvencionuar komunitetet në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës. Në qoftë se keni ndonjë projekt qoftë ndonjë park për fëmijë ose shprehje tjera apo investime kapitale që i shihni të arsyeshme, mund të vini në zyrë dhe të shqyrtojme kërkesat që ju i keni.

**Arianita Beqa – Raci, përfaqësuese nga UNMIK-u:** - tha se, thirrjet për projektet multietnike që janë bërë nga organizatat nderkombëtare, ku për këto projekte keni mundësi që të aplikoni përmes një emaili.

#### **Pika e gjashtë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të ZKKK-së për vitin 2024 dhe për muajin janar 2025**

**Klaudia Mula:** - tha se, sa i përket Raportit mujor të zyrës për muajin janar janë realizuar disa aktivitete të parapara me Planin vjetor të punës. Lidhur me këtë raport dua të jap një sqarim se, më 31.1.2025, në zyrë është paraqitur një anëtar i komunitetit ashkali, të cilët nuk i kanë dal mjetet për blerjen e druve për ngrohje dhe kjo çështje është zgjidhur pasi që Zyra për Komunitete e ka ndërmjetësuar në Drejtorinë e Financave dhe është proceduar prapë lënda që t'i bëhet pagesa anëtarit të komunitetit, kështu e gjithë lista e kërkuar për financim është e planifikuar nga Drejtoria e Financave.

## **Pika e shtatë**

### **Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Komitetit Komunal Veprues për vitin 2024**

**Klaudia Mula:** - tha se, Raporti vjetor i Komitetit Komunal Veprues për vitin 2024, shtrihet në parimet kryesore të referuara në Strategjinë nacionale për avancimin e drejtave të komiteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në Republikën e Kosovës 2022-2026, Planin e veprimit 2022-2024, si dhe të vendimit për formimin e Komitetit Komunal Veprues 2023. Komiteti Komunal Veprues ka hartuar Planin komunal të veprimit për avancimin e të drejtave të komiteteve i cili është miratuar në Kuvendin Komunal në vitin 2023. Gjatë vitit 2024 objektivat e këtij plani sa i përket objektivit të arsimit janë zbatuar shumë aktivitete.

Si objektiv i dytë është punësimi dhe mirëqenia sociale ku parasheh përmirësimin e çështjes së pjesëmarrjes së barabartë në treg të punës përmes sistemit të pjesëmarrjes së komunitetit rom, ashkali, egjiptian, në zyrat komunale për punësim dhe programet e arsimit profesional.

Objektivi i tretë është shëndetësia, ku në këtë objektiv janë zbatuar ose organizuar aktivitete, mirëpo pjesëmarrja e këtyre komuniteteve ka qenë shumë e vogël. Sa i përket objektivit të katërt, parashihen aktivitete që përmirësojnë kushtet e banimit, ku sipas një databaze që është dhënë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale kemi pasur vetëm dy kërkesa që kanë nevojë për strehim.

Si objektiv i pestë është diskriminimi, i cili parashah aktivitete që duhet të përmirësojnë vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe zyrtarëve publikë dhe kundër diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve, ku është promovuar platforma racionale për mbrojtjen ndaj diskriminimit të këtyre komuniteteve.

## **Pika e tetë**

### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre**

**Nenad Miladinoviq:** - tha se, kemi pas takim me përfaqësuesit e komuniteteve ku gjithçka ka shkuar mirë dhe nuk kemi pas asnjë problem, por mbeten vetëm problemet e vjetra të cilat i paraqes gjithmonë në këtë komitet që janë probleme shumë të mëdha, siç janë pastrimi i deponive të mbeturinave, rregullimi i shtratit të lumit në Bërnicën e Poshtme. Sa i përket sigurisë nuk kemi pasur asnjë problem.

## **Pika e nëntë**

### **Të ndryshme**

**Mirsada Behluli,** kryesese tha se në mbledhjen e radhës do ta ftojme përsëri drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave. Po ashtu për mbledhjet e radhës do t'i paraqesim edhe temat të cilat janë të parapara me Planin vjetor të punës, t'i ftojme edhe përfaqësuesit e Kuvendit dhe t'i paraqesim problemet tona të cilat janë më të rëndësishme.

Gjithashtu për në muajin mars e kemi paraparë edhe një vizitë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Takimi i radhës do të mbahet më dt. 18.3.2025

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Mirsada Behluli



Faqe 5 nga 5